



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

KËSHILLI I BASHKISË

Datë 30.10.2023

Prot.10 (dhjetë)

Protokoll nr. 10

I mbajtur sot më datë 30.10.2023, në mbledhjen e radhës së Këshillit të Bashkisë Maliq, në sallën e mbledhjeve të këshillit të bashkisë, ora 10:00.

Rend dite:

1. Hapja e mbledhjes (korumi, miratimi i rendit të ditës, vendimet e mbledhjes së kaluar);
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;
3. P-V “Mbi miratimin e Ndhmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin shtator 2023”
4. P-V “Për miratimin e strategjisë vendore të vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë dhe plani i veprimit në Bashkinë Maliq”;
5. P-V “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.104, datë 19.12.2022, “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në bashkinë Maliq, penalitetet dhe shkeljet apo kundravajtjet administrative për vitin 2023”;
6. P-V “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Bashkisë Maliq nr.55, datë 26.05.2023, “Për detajimin dhe përdorimin e fondit të kushtëzuar për mbrojtjen civile”;
7. P-V “Për detajimin e fondeve për pagesën e detyrimeve të prapambetura”;
8. P-V “Për miratimin e listës të kryetarve të zgjedhur për çdo fshat”;
9. Diskutime të tjera.

Këshilltarë të pranishëm në sallë:

Ornildi Demollari; Petrit Kupe; Rudina Bregu; Eriseld Jonusllari; Pranvera Begolli; Klea Baçi; Enida Avdolli; Dritan Çami; Aramando Dautllari; Marianthi Avrami; Xhuana Hoxhallari; Lulëzim Hoxhaj; Danjela Ibrahim; Ronaldo Skënderi; Fevri Sherifi; Faslli Zholi; Gentiana Drabo; Plator Çollaku; Aleksandra Spaho; Eglantina Balli; Albina Xhejo; Ildir Limllari; Neresida Shindo; Server Xhuti; Andonaq Risto; Almir Elezi; Server Xhuti 27 (njëzetëeshtatë) këshilltarë.

Të pranishëm nga Administrata:

Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu; Përgjegjës i Sektorit të Emergjencave Civile; Stiljan Belishta; Përgjegjëse e Sektorit të Shërbimit Social:znj.Ermanda Petriti;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Ornildi Demollari: Mirëdita të gjithëve! Të nderuar kolegë Këshilltarë, i nderuar Kryetar i Bashkisë, të nderuar pjesmarës, fillojmë mbledhjen e Këshillit të Bashkisë Maliq duke u bazuar në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, kemi thirrur këtë mbledhje të radhës të Këshillit të bashkisë, me materialet dhe njoftimin ju jeni njohur disa ditë përpara. Bëjmë një verifikim të korumit duke bërë apelin, Vijojejmë me apelin. Korumi realizohet kemi 27 e Këshilltarë në sallë, mund të vazhdojmë me rendin e ditës. Ju ftoj të miratojmë rendin e ditës.

Faslli Zholi: Kam diçka para se të miratojmë rendin e ditës, të nderuar kolegë, i nderuar Kryetar i Bashkisë, kam një pronocim në emër të grupit dhe në emrin tim personal, do doja 5 minuta kohë ta lexoja dhe pastaj vazhdojmë. Faleminderit! Kam një pronocim lidhur me rendin e ditës.

Ornildi Demollari: Rendin e ditës ka të drejtë ta miratojë Këshilli.

Aleksandra Spaho: Deklaroj me vullnetin tim se nuk i përkas asnjë grupi politik nga tani jam vetëm Këshilltare e Partisë Demokratike të Shqipërisë. Faelminderit!

Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu: Të gjitha deklaratat dhe pronocimet duhet të protokollohen më parë.

Faslli Zholi: Të nderuar kolegë, i nderuar Kryetar i Bashkisë, ndihme i obliguar për ta sqaruar se është e disata herë që ndodhemi përballë shkëljes së ligjit dhe rregullores të Këshillit bashkiak.

1-Rendi i ditës duhet të miratohet nga Kryesia e Këshillit.

2-Kjo praktikë nuk është bërë.

3-Nuk kemi një rregullore të miratuar dhe të vulosur të Këshillit të bashkisë Maliq, nuk kemi në punë akoma Komisionet e Këshillit, nuk afishohen listat e ndihmës ekonomike në NJ.A, kemi kërkuar sqarim për zonjën Anila Nuri Sulejmani nga NJ.A Libonik. Kemi kërkuar të dhëna për investimet në fshatrat Plasë-Zëmbkal para fatkeqësisë së Majit 2023, cila ka qenë firma ndërtuese dhe kush e ka supervizonin e saj. Kemi kërkuar inventarizimin e gjithë pronave dhe asetëve të bashkisë Maliq, kemi kërkuar mbledhje jashtë radhe për Kryetarët e zgjedhur të fshatrave. Të nderuar këshilltarë, jemi në kushtet ku nuk zbatohet rregullorja dhe ligji në këshill dhe ne në këto kushte ju bëjmë thirrje të reflektoni në të mirë të punve të Këshillit. Këto ishin ato çka kërkonim, ju faleminderit.

Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu: E dëgjova me vëmendje dhe i kam shënim 5-6 pikat që dëgjova, ngre si shqetësim që rendi i ditës të konsultohet me Këshillin e bashkisë, për mua është normale. Unë mendoj që Këshilli i Bashkisë dhe Kryesia duhet t’u shtojnë pika sipas problematikave që dalin, ato që ka programi vjetor i Këshillit apo dhe pikat që kavetë organi ekzekutiv që mendon të shtojë, pika që dalin sipas problematikave të muajit. Në lidhje me rregulloret, rregullore ka të miratuar dhe Këshilli dhe Adminisrta e bashkisë. Komisionet janë ngritur herën e kaluar dhe unë mendoj që çdo herë që ka mbledhje Këshilli, komisionet mblidhen



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

sipas problematikave një ditë para, nëse Kësilltarët nuk vijnë nuk ke çfarë të bësh. Në lidhje me shpallje e listave të ndihmës ekonomike, janë shpallur listat. Në lidhje me znj e Libonikut do doja një informacion brenda ditës të sotme. Në lidhje me përmbytyet në Plasë dhe Zëmbllak, kush e ka marrë si firma, fondet nuk kanë ardhur akoma për investimin. Ne kemi bërë një projekt paraprak për AKMC, projekti është kthyer mbrapsht, ne e kemi ripunuar përsëri, e kemi sjellë në Këshill me ripunim dhe zëra, pasi kishim futur dhe zëra të tjerë, por VKM-ja nuk i përfshinte dhe nuk kemi çfarë të flasim se nuk janë akorduar fondet, për mbikqyrje, kolaudim etj. Për zgjedhjet e Kryetrave të fshatrave P-V ka ardhur sot, do diskutohet dhe do kalojë sipas problematikave që ka patur çdo fshat. Jam i hapur për çdo gjë që ju mendoni se ju shkelet e drejta, tju jap sygjerim anëtarave të pozitës nga unë jam pjesë e tyre, që në çdo rast të jemi qyetarë, vednin ku jam sot nuk e kam politik, e kam pozicion administrativ për të gjithë qyetarët.

Faslli Zholi: Të falenderoj për përgjigjen z. Kryetar!

Ornildi Demollari: Kush është dakord me rendin e ditës? E kalojmë në votim?

Kush është dakord ? 16 vota pro

Kundra? 6 vota kundra

Abstenim? 1

Miratohet 16 vota pro. Faleminderit!

Faslli Zholi: Po flas për investimit në Zëmbllak dhe Plasë në vitin 2021 jo 2023 se jam dakord me këtë që nuk kanë ardhur fondet.

Kryetari i Bashkisë: z. Gëzim Topçiu: Për fshatin Zëmbllak nuk kanë ardhur fonde asnjëherë për emergjenca civile ne me fondet tona kemi bërë investime të vogla.

Faslli Zholi: Faleminderit! Dhe unë këtë informacion doja. Nuk vijë për politikë këtu.

Ornildi Demollari: Nëse vjen si pakicë dhe sillesh si shumicë, patjetër që e ke gabim.

Pranvera Begolli: Kryetar ju lutem të vazhdojmë mbledhjen.

Ornildi Demollari: Po na pengon mbledhjen z. Faslli, vijojmë me rendin e ditës. Më lejoni tju njoh me vendimet e mbledhjes së kaluar të cilat kanë marrë dakortësinë e institucionit të Prefekturës, kemi 7 vendime, 3 me karakter normativ dhe 4 me karakter kolektiv. Kalojmë te pika tjetër rendit të ditës, Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;

Kush është dakord

Kundra?

Abstenim?

Miratohet 27 vota pro. Faleminderit! Kalojmë te pika tjetër rendit të ditës, P-V “Mbi miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin shtator 2023”



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Aleksandra Spaho:Para dy muajsh kam propozuar diçka për fondin e ndihmës 6%, për studentët që nuk mund të përfitojnë bursë për shkak se nuk janë në skemën e ndihmës ekonomike.Nëse është mundësia ti gjejmë një zgjidhje.Kemi 3 studentë në zonë e Përgut që ju duhet ky vërtetim.

Ornildi Demollari:Faleminderit! Kemi diçka tjetër?

Përgjegjëse e Sektorit të Shërbimit Social:znj.Ermanda Petriti:Përshëndetje!Fondi i ndihmës 6% ka disa kritere që familjet duhet të plotësojnë për tu futur në skemë, të cilat miratohen çd fillim viti me VKB dhe është për familjet që dalin me pikë të pamjaftueshme nga sistemi por janë vërtet familje në nevojë.Nuk mund të themi që çdo familje që ka studentë të jetë familje në nevojë., për më tepër të futet në skemë për të përfituar bursë.Nëse familja është në nevojë do e shohim rast pas rasti, patjetër që po.

Ornildi Demollari:Faleminderit!

Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:Nuk e di familjet në fjalë kanë aplikuar në sistem?

Përgjegjëse e Sektorit të Shërbimit Social:znj.Ermanda Petriti:Kur ka mjet dhe është i punësaur nuk mund të trajtohet nga fondi 6 %.

Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:Për të gjitha rastet që keni mund të kontaktoni Përgjegjësën e Ndhmës Ekonomike Ermandën dhe ne atje ku gjejmë mundësitë ligjore pse mos i trajtojmë të përfitojnë bursën.

Ornildi Demollari:Faleminderit! Kemi diçka tjetër?

Kush është dakord 27 vota pro.

Kundra?

Abstenim?

Miratohet 27 vota pro. Faleminderit! Kalojmë te pika 4 e rendit të ditës, P-V "Për miratimin e strategjisë vendore të vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë dhe plani i veprimit në Bashkinë Maliq";Ka ndonjë pyetje?

Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:Ky është një P-V që ju kemi paraqitur ka eksperinca nga Bashki të tjera por dhe të donatrove të ndryshim që japin provjat e tyre në lidhje me Emergjencat, me risqet që duhet të parshikojmë për çdo zonë, ne e kemi detyrim ligjor jo vetëm për ta prezantuar, materiali është voluminoz, ka informacion për Bashkinë, territorin, sipërfaqen, popullsinë dhe risqet.Atje kemi dhënë disa ide për risqet, nëse ka ndonjë propozim? Të shtohet.

Server Xhuti:Kam një propozim për fshatin Zvezdë, investimet në rrugë të bëhen me kalldrëme ose asfalt se Zhavori gjithonë që ka shi ikën.

Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:Po e shohim mundësinë e investimit në ujësjellë në fshatin Zvezdë për ti shtruar më pas të gjitha rrugët me kalldrëme dhe kanali në pjesën lart në fshat.Ndërhyrja që bëme në kanalin lart e ka lehtësuar shumë fshatin nga prurjet.Shqetësim është me vend.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Ornildi Demollari:Faleminderit! Kemi diçka tjetër? E kalojmë në votim?

Kush është dakord? 26 vota pro.

Kundra? 1 kundra Faslli Zholi

Abstenim?

Miratohet 26 vota pro. Faleminderit! Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës, P-V “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.104, datë 19.12.2022, “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në bashkinë Maliq, penalitetet dhe shkeljet apo kundravajtjet administrative për vitin 2023”; Jemi te pika 5.

Aleksandra Spaho:Materiali na ka ardhur me me vonesë dhe unë që jam pjesë e Komisionit të Ekonomisë duhet ta kisha 10 ditë para, nuk mund ta shpreh votën as pro as kundra.Propozoj që mbledhja e Këshillit të bëhet në një datë të caktuar.

Ornildi Demollari:Faleminderit!Kemi diçka tjetër?

Pranvera Begolli:Materialiet na vihen në dispozicion 5 ditë para dhe Komisionet mund të mbledhen 1 ditë ose 1 orë para mbledhjes.

Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:Diçka me P-V, po ju propozojmë një tarifë lidhur me bilaetat e fushës së Sportit, duke qenë se kemi bërë një investim dhe vendosja e një tarife minimale 100 lekë për efekt të që këto të ardhura të përdoren për mirëmbajtjen e fushës, është një vlerë minimale.Komisionet të takohen ose 1 ditë para ose ditën e mbledhjes, thjesht duhet pak angazhim nga Këshilltarët.

Ornildi Demollari:Faleminderit!Kemi diçka tjetër? E kalojmë në votim?

Kush është dakord? 25 vota pro.

Kundra? 1kundra Faslli Zholi

Abstenim? 1

Miratohet 25 vota pro. Faleminderit! Kalojmë te pika 6 e rendit të ditës, P-V “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Bashkisë Maliq nr.55, datë 26.05.2023, “Për detajimin dhe përdorimin e fondit të kushtëzuar për mbrojtjen civile”;Jemi te pika 6 e rendit të ditës.

Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:Është një fond i kursyer nga ana jonë nga procedurat e prokurimit, janë kursyer rreth 751.000 lekë, meqëse po afron dimri, ne të kemi mundësi të kemi dhe 1 mjet ose Fadroma që në raste të caktuara përdoren për zona të thella si Gora, Mogilca apo zona të tjera, në raste fatkeqësish ti kemi, ne e kemi bërë praktikë të kahershme, janë fonde që AKMC i akordon në fillim të vitit dhe për efekt të procedurave të kurimit në prokurime ne mundohimi ti rialokojmë dhe ti përdorim në shërbim të qytetarve.

Ornildi Demollari:Kjo është një metodë shumë e mirë që bashkia jonë ve në zbatim me kursimin e fondeve dhe ato fonde përdoren për herë të dytë.Ka ndonjë pyetje apo koment tjetër?

E kalojmë në votim?

Kush është dakord? 25 vota pro.

Kundra? 2 kundra Faslli Zholi, Almir Elezi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Abstenim?

Miratohet 25 vota pro. Faleminderit! Kalojmë te pika 7 e rendit të ditës, P-V “Për detaji min e fondeve për pagesën e detyrimeve të prapambetura”;

Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:Kjo është një transfertë që na është çelur nga buxheti qëndror në mbyllje të buxhetit dhe për qeverinë qëndrore, na është çelur një fond prej 10 milion lekë, të cilin ne duam ta përdorim për një detyrim të prapambetur, është një objekt që nuk e kemi shlyqer 100% , ne kemi ecur me shlyrjen e detyrimeve dhe faturave të vitit 2023, por kjo ka mbetur falmenderojmë buxhetin e shtetit që na ndihmon me një çelje në këtë fund viti me një vlerë prej 10 milion lekë.Gjej rastin ta falenderoj.

Ornildi Demollari:Faleminderit!Kemi diçka tjetër për pikën 7? E kalojmë në votim?

Kush është dakord? 25 vota pro.

Kundra? 1 kundra Faslli Zholi

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet 25 vota pro. Faleminderit! Kalojmë te pika 8 e rendit të ditës, P-V “Për mirati min e listës të kryetarve të zgjedhur për çdo fshat”;

Faslli Zholi:Jam plotësisht dakord me këtë pikë, kam një pyetje? Ramë dakord të ishin dhe Kryetarët e fshatrave.

Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:Të kalojë vendimi në Prefekturë, pastaj të vijmë.

Faslli Zholi:Për sa i përket pikës, ne e ndoqëm procesin sipas dateve, na kanë mbetur disa probleme të cilat, ka mbetur një fshat në Gorë ka dalë në balotazh dhe Drithasi Poshtë ka një problem ligjor, kemi dhe Zvezdën ku nuk janë bërë zgjedhjet.Për sa i përket fshatrave të tjera ka patur mangësira, ne i kemi diskutuar, por janë mbushur proceverablet dhe unë jam gati për ta përfunduar këtë proces.Faleminderit!

Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:Po ju lexoj P-V ashtu si ju është parqitur dhe ju.Kush ka pretendim ta thotë që tani, që mos i marrim përsëri me radhë.Fshati Desmirë të përsëriten zgjedhjet, Drithas Poshtë të bëhen zgjedhjet dhe kandidatët të jenë banorë të fshatit poshtë.Mendoj që fshati Zvezdë mund të bëhet lagje më lagje, duke zgjedhur anëtar Pleqësie se është gjithë ai fshat, këtë duhet të vendosi Këshilli, Fevriu, Sereveri që e njohin si fshat.Këto janë propozimet e mia për Këshillin. Faleminderit!

Ornildi Demollari:Diçka për fshatin Kolanec, si mbikqyrës i procesit kam qenë unë dhe Skeretari i Këshillit.Procesi atje ka filluar dhe ka vijuar normalisht, pa asnjë pretendim, pas përfundimit të procesit njëra nga palët ka bërë ankesë.Kjo ka ndodhur pas përfundimit të procesit dhe unë gjykoj që Këshilli duhet ta marrë vendimin dhe mos ngelet peng i kësaj pune.

Aleksandra Spaho:Për fshatin Sovjan është e njëjta situata ashtu si tha dhe Kryetar i Këshillit, e njëjta situatë me fshatin Kolanec.Kam qenë në mbikqyrje me Armandon dhe gjatë procesit nuk ka patur asnjë ankesë, proceverabli është firmosur nga të tre anëtarët e Komisionit, të vendosur



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

nga vetë kandidatët. Në lidhje me fshatin Zvezdë, Këshilli morri vendim që votimi të bëhet ose në bazë fshati ose me lagje. Nuk e di kush e morri vendimin që votimi në Zvezdë të bëhet në shkollë ditën e Shtunë ora 9:00, atë ditë nuk ndodheshin kolegët dhe kam shkuar vetë në Zvezdë për të ndjekur procesin, duhet theksuar që kandidati i P.S kishte marrë kutinë e votimit, emrar ishin printuat për tu bërë votimi jo me lagje, palët pretendojnë mëmyra të ndryshme votimi, ose në çdo shtëpi pala tjetër nuk e pranon këtë, të votohet në mes të fshatit. Si do vendos Këshilli tani, proceverablet janë mbajtur sipas ligjit.

Serever Xhuti: Kemi marrë vendim, nëse nuk bëhen zgjedhje të vazhdojë ai që është. Zgjedhjet nuk janë bërë, por kjo është puna e vetë banorve të fshatit, le ta zgjedhë fshati.

Kryetari i Bashkisë: z. Gëzim Topçiu: Ligji e parshikon që e zgjidh fshati mënyrëne votimit, ligji parshikon diçka tjetër, kur nuk ka zgjedhje, Kryetari emëron dikë provizorisht.

Serever Xhuti: Jo me ligj, ne e vendosëm këtu këtë, mendimi im është të vazhdojë ai që është.

Faslli Zholi: Jam plotësisht dakord me mendimet që tha Kryetari i Bashkisë, që të bëhen votimit në fshatrat ku nuk janë bërë zgjedhjet dhe në Zvezdë të bëhen te shkolla. Në Kolanec dhe Sovjan nuk ka probleme të miratohen. Fsahti e zgjedh vetë formën so do qeveriset.

Serever Xhuti: Zgjedhjet i bën vetë fshati.

Faslli Zholi: Dhe në Drithas të bëhen votimet.

Ornildi Demollari: Faleminderit! Duke miratuar fillimisht ata që nuk kanë patur kontestime që ju i keni në material, duke miratuar dhe Kolanecin dhe Sovjanin, për të cilat ka ankesë, por këshilli nuk mund ti anulojë zgjedhjet, spese ankesa ka ardhur pas përfundimit të procesit, në Desmirë të ketë përsëritje të zgjedhjeve, në Zvezdë të bëhen.

Kryetari i Bashkisë: z. Gëzim Topçiu: Të miratohen Kryetarët e fshatrave ku nuk ka probleme, ku shtohen dhe Kolaneci dhe Sovjani që kishin ankesë, e dytja ketë përsëritje të zgjedhjeve në Desmirë, e treta të realizohen zgjedhje atje ku nuk janë realizuar. Për Zvezdën do sygjeroja të bëhen me lagje ashtu si tha Serveri, le ta rregullonë vetë, të bëhen zgjedhje në fshatin Drithas Poshtë dhe anëtarët ose Kryetari i fshatit të jetë brenda listës së votuesve dhe banor i fshatit poshtë, se ka pretendime se kërkojnë të jenë nga Drithasi lart ose Libonik, këtë e shkuan ligji, por ne ta citojmë, të jetë në listat e zgjedhjeve të fundit.

Ornildi Demollari: Faleminderit! Me këtë përmbledhje mund ta kalojmë në votim? Në Zvezdë dhe Drithas Poshtë të zhvillohen zgjedhje.

E kalojmë në votim?

Kush është dakord? 26 vota pro.

Kundra? Nuk ka.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet 26 vota pro. Faleminderit!

Lulëzim Hoxhaj:Për sa i përket fshatit Drithas, kush do votojë në Drithas dhe Zvezdë, po të merren parasysh listat e votimeve, unë jetoj në Tr dhe vendbanimin e kam në Drithas, duhet të jete me vendbanim atje në fshat.

Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:Të jetë rezident atje.

Ornildi Demollari:Faleminderit!Edhe njëherë miratohet, punë të mbarë atyre që u zgjodhën dhe sukeste kandidatave që do zgjidhen në këto fshatra që nuk janë zhvilluar zgjedhjet. Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës, Diskutime të tjera.Ku është një informacion për Këshilltarin Z.Yllson Ibrahimllari, për zonën e Lenies, në një mbledhje më parë e spostuam sot e kemi sjellë në një formë informacioni.Kryetar!

Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:Këshilltarët, besoj se janë njohur me materialin, të cilin dua ta koncentroj në disa pika.Po ja u lexoj materialin.(bashkangjitur).Materialin e shoh me intreres, në kuptim, pse mos kemi dhe ne sa më shumë zona të mbrojtura.Duke e marrë materialin nga fillimi përveç ligjeve të zonave të mbrojtura pjesa tjetër janë shufqizuar, idea ka qenë e mirë, materiali është marrë në faqen web të zonave të mbrojtura, në këtë material mungojnë dy vendime me rëndësi.Për kërkesën Park Kombëtar, këtu kemi ndryshimin e i ideve, ne mund ta propozojmë, por të Park Kombëtar kategori e parë, duhet të jenë rezereva strikte shtetërore sipas ligjit për zonat e mbrojtura.Por le të shihet nga Këshilli, por duhet të jetë e argumentuar nga ana ligjore dhe juridike, për efekt të asaj që ne e shprehim, se do ja çojmë Ministrisë së Mjedisit, ata e dërgojnë në Këshillin e Ministrave për të marrë formën e P-Ligjit të shkojë në Parlament, nëse propozuesit shikojnë se ju është shkelur e drejta nuk kam kundërshtim.Materiali i parqitur nuk është studim, por kopje e marrë nga interneti nga P-V i Këshillit të Ministrave.Faleminderit!

Ornildi Demollari:Faleminderit!Po.

Lulëzim Hoxhaj:Së pari vlersoj informacionin, ishte i plotë dhe shterues, idea kur ne sollëm materialin, nuk ishte se është bërë një studium i plotë, nuk është propozim për Park Kombëtar, por thjesht një iniciativë, mendoj që kalimi i kësaj zone Park Kombëtar, ka avantazhe dhe disavantazhe.Kam një sygjërim që të shpallet Park Kombëtar, nuk ishte studim i mirëfilltë, por thjesht një informacion i marrë nga burime të ndryshme.Për të kaluar nga ajo zonë në Park Kombëtar, duhet të plotësohen kritere strikte.

Ornildi Demollari:Faleminderit!Kryetari e tha jemi të hapir për propozime.

Lulëzim Hoxhaj:Në emër të grupit dhe propozuesit e vlersojmë informacionin.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:Ajo çka ndodhi këtu në mbledhje, ti shkojë Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, duke i kërkuar një mendim që kjo zonë brenda kuadrin ligjor, mund të bëhet Park Kombëtar?

Ornildi Demollari:Faleminderit Kryetar! Urdhëro.

Aleksandra Spaho:Ashtu si tha dhe Kryetari me Lulëzimën, nëse duhet ndonjë fond për specialist të zonës ose nga Tirana ta miratojmë.

Ornildi Demollari:Jemi te diskutime të tjera, ka diçka tjetër?

Dritan Çami:Kam unë diçka, dua të ngre shqetësimin për një familje në fshatin Podgorie që është në kushte të vështira ekonomike, ta ndihmojmë me një ndihmë financiare.Familja me mbiemër Duro, ka patur aksident.

Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:Kemi të bëjmë me një rast aksidenti, ku i aksidentuari është ndarë nga jeta dhe shtetë e familjes është e vështirë, si ekonomike dhe infrastruktura e shtëpisë, ne duhet ta kishim trajtuar atë si familje të cilës duhet tja reabiltonim shtëpinë, pro problemi i kësaj familje është mungesa e dokumentave të shtëpisë.Po realizojmë një projekt për reabilitimin e çatave, dyer, të 51 godinave.Zyra e ndihmës duhet ta shoh si rast ti japë një ndihmë financiare për atë që i ndodhi dhe për të parë reabilitimin e shtëpisë.

Almir Elezi:Për rastin që u diskutua në mbledhjen e parë, të ardhurat e tij janë 50.000 lekë, por ka dhe nipin të sëmurë, këto të ardhura janë bashkë me nipin.

Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:Nuk e kemi problem që qyterarët të dalin në media dhe të shprehin problematikat që kanë sepse jemi një bashki me probleme të shumta.Ajo çka unë kam cituar për të ardhurat që familja merr, mundësia e vetme që ne ti ndihmojmë ti vemë në dispozicion një mjet ti transportojë të bëjnë dializën në Korçë.Të na sillit një propozim konkret për këtë kategori dhe të shohim si do veprojmë.Për rastin konkret të Podgories ne nuk kemi një P-V sot, me sa di ka një kërkesë, ne duhet ta ndihmojmë si Këshill., nëse Këshilli bie dakord? Nuk e di si është gjendja financiare në bashki, por do mendoja që kësaj familje ti japim një fond prej 150.000 lekë, të mbulojë shpenzimet dhe të reabiltojë banesën, pasi nuk ka dokumenta, ta marrim një vendim edhe pse nuk kemi P-V.Ta ndihmojmë dhe me strukturat tona për të bërë çatinë.

Ornildi Demollari:E marrin si vendim propozimin e Dritanit, 150.000 lekë?

Kush është dakord? 26 vota pro.

Kundra? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet 26 vota pro. Faleminderit! Duke shpresuar që ti kemi ardhur në ndihmë.

Andonag Risto:Kemi dhe një rast për të ndihmuar në fshatin Zvirinë, ka pësuar dhe ai aksident, është në gjendje të vështirë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:Dakord! Na silli një propozim konkret, ta shoihm gjatë kësaj periudhe dhe shohim se çfarë mund të bëjmë duke e ndihmuar dhe me ndonjë paketë ushqimore nga Shoqatat si Dorkas etj dhe pastaj nëse duhet diçka tjetër do isha shumë dakord dhe pjesën e personave që marrin dializë, Ermanda duhet ta shohim me përparësi, na bënë një P-V se si mund ti mbulojmë ne me lekë, për të gjitha rastet që ka bashkia.

Albina Xhejo:Përshëndetje Kryetar, përshëndetje të gjithëve!Jemi te pika diskutime të tjera, dua të ngre një shqetësim për fshatin Zvirinë, bëhet fjalë për rrugën nga kisha në fshat dhe e dyta dua të ngre shqetësimin e ujit të pijshëm dhe çezmat e fshatit nuk kanë ujë kur u bë asfaltimi i rrugës. Faleminderit!

Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:Zvirina ka marrë një investim të madh nga FSHZH, problemtikat do jenë gjithmonë dhe rruga e Kishës duhet parë, bashkë me ato të parcelave ku kemi investuar shumë, në lidhjen e Zvirinës me Velitërnën dhe Vreshtasin, do e shoh si rast.Në lidhje me ujin e pijshëm Zvirina, atje mendohet që të gjithë kanë ujë, me puse dhe etj.Zvirina ka një përbërje gjeologjike që nuk mund të marrësh ujë me thithje, ne po mendojmë që Zvirina të ketë një ujësjellës të madh rajonal që do zgjidhë gjithë problematikën të ujit nëNJ.A Pirg.Drjetoria Rajonale po mendon vitin që vjen për një ujësjellës të madh rajonal i cili do jetë për 20 mijë banorë.

Albina Xhejo:Deri sa të bëhet i mundur investimi në familje, çezmat që shteruan të vihen në funksion.

Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:Do ta shoihm dhe këtë problem, do ta delegoj këtë shqetësim patjetër.

Ornildi Demollari:Nën/kryetari ka kërkaur fjalën.Pas mbledhjes së Këshillit kemi dhe mbledhjen e Asamblesë së Kombinatit të Sheqerit Sh.a Maliq, do ju lutesha mos largoheshit.

Faslli Zholi:Në lidhje me komunitetin kam disa probleme, në lidhje me ujin atje ku banoj unë, ka dëmtime të rrugës, sepse uji ka qenë në sipërfaqe, të rriparohen pjesët e dëmtuara të rrugës dhe të vendosen tuba të rinj, kam shqetësim dhe ndriçimin rrugor në lagje ku jetoj, nuk ndizen natën.Dhe kam dy kërkesa nga dy qytetarë, një banor në Drithas kërkon riparimin e çatisë quhet Ramzan Biba, nëse është e mundur të ndihmohet dhe diçka tjetër kam në fshatin Popçisht është një banor kërkon të bëjë një stallë në tokë e tij, por nuk e pajisin me lejë dhe në fshatin Mesmal është dënuar një familje se ka bërë një kasolle 5 milion lekë.Nëse ka klauzola ti ndihmojmë, këto doja të thoja. Faleminderit!

Ornildi Demollari: Faleminderit!

Lulëzim Hoxhaj:Duke marrë shkas nga ato që tha Faslliu, mu qefi që pashë dikë që do ndërtonte diçka në fshatin Nikollarë, po ai tha nuk më lejojnë, kjo është absurde!Shteti Grek ka një rregull që brenda rrethimit ata ndërtojnë çfarë të duan.Kërkesat personale nuk është vendi që



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ti zgjidhim, por nëse kemi mundësi ti zgjidhim ne si Këshilltarë të kontribuojmë, para dy mbledhjeve Kryetari ngriti një shqetësim në Pojan, është një rast që duhet ndihmuar, gjej rastin të falenderoj Këshilltarin Yllson Ibrahimllari për aparturën që i dhuroi zonjës.Ky më duket shembull shumë që dhe ne Këshilltarët e tjerë duhet ta ndjekim.

Ornildi Demollari:Kolegu e kërkoi me modesti vetë ta ndihmonte familjen, e falenderojmë kolegun.

Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:Në lidhje me problemtaikat, nuk do i hiqja asnjë presje asaj që tha Luli, që nuk dalim dot po u morrëm ne me të gjithë problemtaikat, lidhja duhet bërë me zyrat përkatëse për ti shkuar deri në fund zgjidhjes së problemit.Në lidhje me banesat, ne jemi në vitin e katërt që reabiltojmë banesa dhe numri në total shkon në 200 shtëpi që ne ju bëjmë çatitë e reja, për ta realizuar këtë shtëpia duhet të ketë dokumenta, kusha i ka dokumentat të paraqitet te zyra e strehimit me kopje të tapisë., grupi jonë shkon verifikon në vend, në këtë periudhë që flasim po bëjmë projektin për vitin tjetër.

Ornildi Demollari: Faleminderit!Kemi diçka tjetër?

Aleksandra Spaho:Jemi para miratimit të buxhetit, të përjashtohen personat e vetmuar nga tarifat vendore.Ka diferencë në të ardhurat që kanë këta dhe me detyrimet që kanë, të shihet mundësia të ndihmohen, se nuk besoj se ka shumë të moshuar të vetëm, ti përjashtojmë ose ti kompesojmë.

Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:Në Paketën Fiskale ne kemi një numur që përjashtojmë nga tarifat vendore, Këshilltarët duhet të jenë më bashkëpunues në kuptimin e mirë të fjalës me bashkinë, duke çuar dhe raste konkrete me probleme.Të jemi të gjithë në ndihmë të komunitetit që shpesh herë nuk ka mundësi dhe nuk është i informuar dhe kjo është në atë prizimin që tha Lulëzimi që të kontribuojmë të gjithë nga pak, jo vetëm me vlerë monetare.

Ornildi Demollari:Nëse nuk kemi diçka tjetër? E mbyllim mbledhjen e Këshillit këtu, ju falenderoj të gjithëve.

Mbajtës Protokolli

SEKRETARI I KËSHILLIT

Gertjan GJIRITI

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI
